

**Vendim nr. 78 datë 15.04.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 15.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (J) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** JONUZ DACI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2965, datë 13.07.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41, 42, 43, 131, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Jonuz Daci ka punuar si mësues në Shkollën e Mesme të Bashkuar Zall-Herr. Me vendimin nr. 126, datë 16.02.2010 të Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë, kërkuesi është

kaluar nga mësues definitiv në komandim si mësues me kontratë, duke mos iu rinovuar kontrata e punës dhe si rezultat është larguar në mënyrë të menjëhershme nga puna. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e të paditurit për ta dëmshpërblyer me 12 paga si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, me 2 paga për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës dhe 3 paga për mosrespektim të afatit të njoftimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1512, datë 04.02.2014, ka vendosur moskompetencën dhe dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 2976, datë 06.06.2014, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Jonuz Daci 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit, t’i paguajë paditësit Jonuz Daci, 3 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës pa respektuar afatin e njoftimit. Detyrimin e palës së paditur, t’i paguajë paditësit Jonuz Daci, 8 muaj pagë për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Detyrimin e palës së paditur, t’i paguajë paditësit Jonuz Daci, 3.5 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë [...]”*. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala e paditur, Drejtoria Arsimore Rajonale e qarkut Tiranë, e cila ka kërkuar rrëzimin e padisë, si dhe ankim kërkuesi, i cili ka kërkuar pranimin e plotë të padisë.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2670, datë 10.12.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2976, datë 06.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës nuk ishte respektuar nga punëdhënësi dhe zgjidhja ishte bërë pa shkaqe të justifikuara. Për sa i përket dëmshpërblimit, ajo ka lënë në fuqi arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, bazuar në një vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara dhe parashikimeve ligjore të Kodit të Punës. Kërkuesi dhe Drejtoria Rajonale Arsimore e qarkut Tiranë kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2965, datë 13.07.2023, ka vendosur mospranimin e rekruseve, me arsyetimin se nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*).

5. Në datën 19.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000 me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 28.02.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin që të merrte në shqyrtim pretendimet e kërkuesit të ngritura në rekurs që kishin të bënin me kuptimin dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Punës. Gjykata e Lartë është mjaftuar me arsyetimin se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve në rekurs, i cili nuk përmbush standardin e arsytimit të vendimit.
- 6.2. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në tejkalim të afatit të arsyeshëm. Rekursi është regjistruar në vitin 2016, ndërsa vendimi i saj është dhënë pas 8 vjetësh, në kundërshtim me afatet ligjore të parashikuara.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vëren se kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi i plotëson kriteret paraprake të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000.

9. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në tejkalim të afatit të arsyeshëm. Sipas tij rekursi është regjistruar në vitin 2016, ndërsa vendimi i asaj gjykate është dhënë pas 8 vjetësh, në kundërshtim me afatet ligjore të parashikuara. Në lidhje me këtë pretendim, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, nuk rezulton që kërkuesi t'i jetë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, duke mos arritur të provojë në këtë mënyrë mungesën e efektivitetit të këtyre mjeteve ligjore për mbrojtjen e së drejtës së tij për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një aspekt i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet për sa i përket këtij pretendimi, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive.

10. Për rrjedhojë, në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Kolegji vlerëson të analizojë pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*

11. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë kishte detyrimin që të merrte në shqyrtim pretendimet e tij të ngritura në rekurs të cilat kishin të bënin me kuptimin dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Punës. Gjykata e Lartë është mjaftuar me arsytimin se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve në rekurs, i cili nuk përmbush standardin e arsytimit të vendimit.

12. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi me objekt detyrimin e të paditurit për ta dëmshpërblyer si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës, për mosrespektim të afatit të njoftimit, si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se zgjidhja e kontratës ka qenë e menjëhershme dhe për shkaqe të pajustificuara. Për këtë shkak, pretendimi i kërkuesit për dëmshpërblimin me 2 muaj paga për mosrespektimin e

procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, 3 muaj pagë për mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe 3.5 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi në punë është i bazuar. Ndërsa në lidhje me pretendimin për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, ajo gjykatë ka vlerësuar dëmshpërblimin në masën 8 paga dhe jo 12 paga, sikundër ka pretenduar kërkuesi. Me të njëjtin arsyetim Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm.

16. Kërkuesi i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se dy gjykatat më të ulëta nuk kanë vlerësuar drejt Kodin e Punës, për sa i përket dhënies së dëmshpërblimit në masën 12 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Gjithashtu, ato gjykata duhej të kishin vendosur rikthimin e tij në detyrë, sikurse pranohet nga shkresa e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursat nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Gjithashtu, ai ka konstatuar se në rekurse nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, sipas Gjykatës së Lartë, nuk pretendohet se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të asaj gjykate, si dhe asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga rekursuesi në mjetin e tij të ankimit përpara Gjykatës së Lartë. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka çmuar se Gjykata Administrative e Apelit u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të palës rekursuese, ndaj nuk ka vend për përsëritjen e tyre (*shih paragrafët 13-14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këto arsye, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

18. Në analizë të përmbajtjes së pretendimeve të kërkuesit të paraqitura në rekursin e tij përpara Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se ato janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit procedural dhe me zbatimin e gabuar të ligjit material. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë i ka verifikuar ato në funksion të aksesit në gjykatë dhe ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se shkaqet e paraqitura janë haptazi të pambështetura në ligj. Gjithashtu, vendimi i kësaj gjykate, ndonëse me arsyetim të kufizuar, nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e Kolegjit, në

vështrim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, për natyrën e këtyre shkaqeve. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit janë haptazi të pabazuara.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.